



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2025

Shtojca 15.

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

Data 14/04/2025.

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) ☒ **X** ose

“BAMI HOLDING” Shpk, me Nuis J94416206R, me adrese Rruga “Kameras”, Fushe Kruje, Kruje, Durres.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒ **X**

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☒ **X** **JO** ☐

Subjekti Mbështetës: Operatori Ekonomik "DENOLT" Shpk, me Nuis K48021210Q dhe me oferte ekonomike Kolsh, Lagjja “Todaj”, Rruga Nacionale Kukes-Tirane Km 5, Ndertese Nr. 1, Kukes.

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) ☒ **X** ose

“PE - VLA - KU”, me Nuis K61716013M, me adrese Njesia Bashkiake Nr. 9, Rruga “Muzaket”, Pallatet “Vokshi”, Hyrja 1, Kati 7, Tirane.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒ **X**

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☒ **X** **JO** ☐

Subjekti Mbështetës: Operatori Ekonomik “AVDULI” Shpk, me Nuis J66703306O dhe me adrese Lagjja “10 Korriku”, Rruga “Perlat Rexhepi”, Objekt 3-katesh nr. 4, Kati 1, Vlore.

Subjekti Mbeshtetes: Operatori Ekonomik "PE -VLA-KU SH.P.K. Dega në Kosovë", me Nr. Nipti 810794463 dhe me adrese Prishtine, Jakov Xoxa L-A, K-7, Nr. 54, Kosove.

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) **X** ose

"G.P.G. COMPANY", me Nuis J64324443V, me adrese Lagjja "18 Tetori", godine 1 kateshe, tek nyja e prodhimit Asfalto-Betonit, prane Rotondos se Plukut, Lushnje, Fier.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** **X**

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** **X**

Drejtuar:

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) X

"PEPA GROUP GROUP" Shpk, me Nuis L42215009L, me pjesemarrje prej 58.5 % dhe me adrese Autostrada Tirane-Durres km-6, Zona Kadastrale nr. 2105, Nr. Pasurie 1168/13, Kashar, Tirane, &

"SHPRESA – AL" Shpk, me Nuis K31321021N, me pjesemarrje prej 41.5 % dhe me adrese Njësia Bashkiake Nr. 9, Rruga "Urani Pano", mbrapa "Veve Center", Pallati Nr. 11, Kati 2, Tirane,

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** **X**

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** **X**

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) **X** ose

"BE - IS SH.P.K", me Nuis K71412003A dhe me adrese Godina Nr. 2, Heci Veleshice, Kalis, Zall Kalis, Kukes.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** **X**

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO X JO ☐

Subjekti Mbeshtetes: Operatori Ekonomik “ERGI” Shpk, me Nuis K02727229P dhe me adrese Autostrada Elbasan-Metalurgji km. 3, numri i pasurise 328/6-NDI, zona kadastrale nr. 8526, Lagjja 28 Nentori, Rajoni nr. 3, Elbasan,

Subjekti Mbeshtetes: Operatori Ekonomik “GERTI” Shpk, me Nuis J96829417K dhe me adrese Lagjja “Minatori”, Rruga “Sami Frasheri”, Pallati 23, shkalla 1, kati 1, Godina 4, zona kadastrale 8612, Bulqize, Diber,

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) X ose

“SALILLARI” Shpk, me Nuis J62903125G dhe me adrese Lagjja “4 Shtatori”, nr. Pasurie 1/28, Zona Kadastrale nr. 3682, Ura Vajguore, Dimal (Ish Magazinat), perballe Komisariatit te Policise Ura Vajguore, Bashkia Dimal, Berat.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) X ose

“2 T” Shpk, me Nuis K01731001M dhe me adrese Rruga “Asim Vokshi”, Nd. 14, H. 4, Ap. 5, Tirane.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO X JO ☐

Subjekti Mbeshtetes: Operatori Ekonomik “APIS CONSTRUCTION” Shpk, me Nuis L41513008A dhe me adrese Njesia bashkiake Nr. 2, Rruga “George W.Bush”, Pallati nr. 1, Kati 3, Ap. nr. 26, (Prane ures se Tabakve), Tirane.

Tipi i Kontratës: Pune.

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur.

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: REF-37586-02-11-2025.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale ne administrim te Bashkise Lezhe”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj nga nenshkrimi i Marreveshjes Kuader.

Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 07/04/2025.

¹Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: Buletini Nr. 18, datë 14 Prill 2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

- 1- Operatori Ekonomik “2 T” Shpk, me Nuis K01731001M dhe me oferte ekonomike 261,075,625.65 (dyqind e gjashtedhjetë e një milion e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë pike gjashtedhjetë e pesë) Lek pa Tvsh,
 - Subjekti Mbeshtetes: Operatori Ekonomik “APIS CONSTRUCTION” Shpk, me Nuis L41513008A dhe me adrese Njesia bashkiake Nr. 2, Rruga “George W.Bush”, Pallati nr. 1, Kati 3, Ap. nr. 26, (Prane ures se Tabakve), Tirane.
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X
- 2- Operatori Ekonomik “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” Shpk, me Nuis K91628013D dhe me oferte ekonomike 253,628,577.78 (dyqind e pesëdhjetë e tre milion e gjashtëqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë pike shtatëdhjetë e tetë) Lek pa Tvsh,
 - Subjekti Mbeshtetes: Operatori Ekonomik “ALKO-IMPEX General Construcion” Dege e shoqërisë së huaj, me adrese Rruga “Reshit Petrela”, Kompleksi “Usluga”, kati i 8, prane stacionit te trenit, Tirane.
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X
- 3- Operatori Ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis J91915001P dhe me oferte ekonomike 170,792,778 (njëqind e shtatëdhjetë milion e shtatëqind e nentëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë) Lek pa Tvsh,
 - Subjekti Mbeshtetes: Operatori Ekonomik “JUBICA.” Shpk, me Nuis K26529001I dhe me adrese Rruga “Luigj Gurakuqi”, “Kukleji”, nr. 108, Shkoder,
 - Subjekti Mbeshtetes: Operatori Ekonomik “K.TURJA” Shpk, me Nuis K81314014A dhe me adrese “Bubq”, “Budull”, prane Ures se Gjoles, Durrës.

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

- 4- Operatori Ekonomik “BAMI HOLDING” Shpk, me Nuis J94416206R dhe me oferte ekonomike 225,174,859.56 (dyqind e njezet e pese milion e njeqind e shtatedhjetë e kater mije e teteqind e pesedhjetë e nente pike e pesedhjetë e gjashtë) Lek pa Tvsh,
- Subjekti Mbeshtetes: Operatori Ekonomik "DENOLT" Shpk, me Nuis K48021210Q dhe me oferte ekonomike Kolsh, Lagjja “Todaj”, Rruga Nacionale Kukes-Tirane Km 5, Ndertese Nr. 1, Kukes.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

- 5- Operatori Ekonomik “BE - IS SH.P.K”, me Nuis K71412003A dhe me oferte ekonomike 246,753,329.34 (dyqind e dyzet e gjashtë milion e shtateqind e pesedhjetë e tre mije e treqind e njezet e nente pike tridhjetë e kater) Lek pa Tvsh,
- Subjekti Mbeshtetes: Operatori Ekonomik “ERGI” Shpk, me Nuis K02727229P dhe me adrese Autostrada Elbasan-Metalurgji km. 3, numri i pasurise 328/6-NDI, zona kadastrale nr. 8526, Lagjja 28 Nentori, Rajoni nr. 3, Elbasan,
- Subjekti Mbeshtetes: Operatori Ekonomik “GERTI” Shpk, me Nuis J96829417K dhe me adrese Lagjja “Minatori”, Rruga “Sami Frasheri”, Pallati 23, shkalla 1, kati 1, Godina 4, zona kadastrale 8612, Bulqize, Diber,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

- 6- Operatori Ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” Shpk, me Nuis K81716011V dhe me oferte ekonomike 194,286,239 (njeqind e nentedhjetë e kater milion e dyqind e tetedhjetë e gjashtë mije e dyqind e tridhjetë e nente) Lek pa TVsh,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

- 7- Operatori Ekonomik “CURRI” Shpk, me Nuis J67902718S dhe me oferte ekonomike 218,713,762.94 (dyqind e tetembedhjetë milion e shtateqind e trembedhjetë mije e shtateqind e gjashtedhjetë e dy pike nentedhjetë e kater) Lek pa Tvsh,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

- 8- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” Shpk, me Nuis K82230002K & “BAJRAMI N.” Shpk, me Nuis K02727202O dhe me oferte ekonomike 249,443,641 (dyqind e dyzet e nente milion e katerqind e dyzet e tre mije e gjashtëqind e dyzet e nje) Lek pa Tvsh,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

- 9- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “EUROKOS HOLDING SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI” Dege e shoqërisë së huaj, me Nuis K91727010A & “A.L-ASFALT” Shpk, me Nuis K81511508A dhe me oferte ekonomike 169,845,048.45 (njeqind e gjashtedhjetë e nente milion e teteqind e dyzet e pese mije e dyzet e tete pike dyzet e pese) Lek pa Tvsh,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

- 10- Operatori Ekonomik “G.P.G. COMPANY”, me Nuis J64324443V dhe me oferte ekonomike 240,274,623 (dyqind e dyzet milion e dyqind e shtatedhjetë e katër mijë e gjashtëqind e njëzet e tre) Lek pa Tvsh,
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X
- 11- Operatori Ekonomik “KTHELLA”, me Nuis J69303023D dhe me oferte ekonomike 187,059,626.48 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë milion e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë pike dyzet e tetë) Lek pa Tvsh,
- Subjekti Mbeshtetes: Operatori Ekonomik “REJ” Shpk, me Nuis J93711608Q dhe me adresë Zogu i Zi, Qatar Center, kati 2, Tirane.
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X
- 12- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “LIS KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis K66613407H & “VIANTE Konstruksion” Shpk, me Nuis K47103804L dhe me oferte ekonomike 229,755,353.53 (dyqind e njëzet e nëntë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e tre pike pesëdhjetë e tre) Lek pa TVsh,
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X
- 13- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “NDERTIMI shpk” Shpk, me Nuis K11325002C & “ELMAZAJ KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis L33229401T dhe me oferte ekonomike 210,824,136 (dyqind e dhjetë milion e tetëqind e njëzet e katër mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë) Lek me Tvsh,
- Subjekti Mbeshtetes: Operatori Ekonomik “NDREGJONI” Shpk, me Nuis K31329048I dhe me adresë Njesia Bashkiake Nr. 8, Rruga “Sule Bega”, Ndertesa Nr. 32, Hyrja 8, Tirane.
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X
- 14- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “PEPA GROUP GROUP” Shpk, me Nuis L42215009L & “SHPRESA - AL” Shpk, me Nuis K31321021N dhe me oferte ekonomike 241,947,561.98 (dyqind e dyzet e një milion e nëntëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një pike nëntëdhjetë e tetë) Lek pa Tvsh,
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X
- 15- Operatori Ekonomik “PE - VLA - KU”, me Nuis K61716013M dhe me oferte ekonomike 232,262,318.88 (dyqind e tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e tetëmbëdhjetë pike tetëdhjetë e tetë) Lek pa Tvsh,
- Subjekti Mbeshtetes: Operatori Ekonomik “AVDUL” Shpk, me Nuis J66703306O dhe me adresë Lagjia “10 Korriku”, Rruga “Perlat Rexhepi”, Objekt 3-katesh nr. 4, Kati 1, Vlore.
- Subjekti Mbeshtetes: Operatori Ekonomik “PE –VLA-KU SH.P.K. Dega në Kosovë”, me Nr. Nipti 810794463 dhe me adresë Prishtinë, Jakov Xoxa L-A, K-7, Nr. 54, Kosovë.
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X
- 16- Operatori Ekonomik “SALILLARI” SHpk, me Nuis J62903125G dhe me oferte ekonomike 250,000,000 (dyqind e pesëdhjetë milion) Lek pa Tvsh,
OE/BOE me nënkontraktor

- PO ☐ JO X
- 17- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “VARAKU E” Shpk, me Nuis J61902509S & “L.T.E CONSTRUCTION” Shpk, me Nuis L78006801F & “KOMBEAS” Sh.a, me Nuis K88103301J dhe me oferte ekonomike 217,029,680.70 (dyqind e shtatembdhjete milion e njezete nente mije e gjashteqind e tetedhjete pike shtate) Lek pa Tvsh, OE/BOE me nënkontraktor
- PO ☐ JO X

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

I- Operatori Ekonomik “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” Shpk, me Nuis K91628013D,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, rezulton se nuk ploteson kriterin 2.3.1, te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se: “Operatoret Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.1/a Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratën;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Faturat tatimore;
5. Aktin e kolaudimit;
6. Çertifikatë e marrje në dorezim/ Çertifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim .

2.3.1/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë sipermarrje;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore;
4. Akt kolaudimi objekti;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në Bashkim”.

Theksojme se per te permbushur piken 2.3.1, ne lidhje me dëshmitë për pervojen e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë pese viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, OE duhet te paraqesin dokumentacion per realizimin e puneve te ngjashme me vlere jo me te vogel se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet per nje objekt te vetem ose pune te ngjashme ku vlere totale e puneve eshte jo me te vogel se dyfishi i vleres limit te kontrates qe prokurohet. Gjithashtu per kontratat e realizuara me autoritete publike OE duhet te paraqesin per gjithë secilen kontrate Formularin e vlerësimit, Situacionin përfundimtar, Faturat tatimore, Aktin e kolaudimit dhe Çertifikatën e marrje në dorezim ose Çertifikatën e përkohshme e marrjes në dorëzim.

Bazuar ne pikat 19 dhe 20, te nenit 4, te Ligjit Nr. 162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, parashikohet se:

19. “Kontrata publike për punë” janë kontratat publike që kanë si objekt të tyre:

- a) kryerjen ose projektimin dhe kryerjen e punëve në lidhje me një ose më tepër aktivitete ndërtimore, sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik;
- b) realizimin ose projektimin dhe realizimin e një pune;
- c) realizimin me anë të çdo mjeti të një pune, që përkon me kërkesat e specifikuara nga autoriteti kontraktor që ushtron një ndikim vendimtar në llojin ose projektin e punës.

20. “Kontratat publike për shërbime” janë kontratat publike, që kanë objekt kryerjen e shërbimeve, të tjera nga ato që përfshihen në pikën 19 të këtij neni.

Sa me siper nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se operatori ekonomik per plotesimin e ketij kriteri ka paraqitur nje “**Kontrate sherbimi**” dhe jo “**Kontrata publike për punë**”, kjo ne kuptim te pikave 19 dhe 20, te Nenit 4, te Ligjit Nr. 162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK, si dhe bashkengjitur dhe dokumentacionin provues per kryerjen e sherbimit objekt i kesaj kontrate te paraqitur, konkretisht: Kontraten e Sherbimit, Formularin e Vleresimit, Situacione sherbimi (**pa zera konkrete punimesh**) si dhe faturat tatimore.

Nderkohe rezulton se nuk eshte paraqitur asnje “Akt Koludimi punimesh” dhe “Çertifikatën e marrje në dorezim” ose “Çertifikatën e përkohshme e marrjes në dorëzim”, kerkesa keto ne dokumentat e tenderit.

Theksojme se dokumentacioni i paraqitur nga ky operator ekonomik per te provuar realizimin e puneve te ngjashme nuk eshte dokumentacioni i kerkuar ne DST per te provuar realizimin e puneve pasi mungojne Akt Koludimi punimesh dhe Çertifikatën e marrje në dorezim ose Çertifikatën e përkohshme e marrjes në dorëzim, dokumentacion ky i kerkuar si kusht per plotesimin e kriterit te vecante ne piken 2.3.1 te Dokumentave Standarte te Tenderit.

Si me siper, operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e parashikuara ne DST për eksperiencat e mëparshme të ngjashme dhe ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore

përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” Shpk, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” Shpk, me Nuis K91628013D, skualifikohet.

II- Operatori Ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis J91915001P,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE, rezultoi se Operatori Ekonomik nuk plotëson kriterin 2.3.9, të kushteve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronesi, qira ose kontrate bashkëpunimi impiantet si më poshtë vijon:

a. 1 (nje) Impiant prodhimi Inerte

b. 1 (nje) Impiant prodhimi Asfalti

c. 1 (nje) Impiant prodhimi Betoni

Për impiantin e prodhimit të inerteve/asfaltit/betoni, në rast se është në pronesi duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronesinë e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që vërteton pronesinë. Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/asfaltit/betoni, është me qera ose kontrate bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qerash/bashkëpunimit. (KVO do të verifikojë nepermjet QKB nëse impianti i prodhimit të inerteve/asfaltit/betoni është i pajisur me license 3.1.B, në rast të kundërt OE do të skualifikohet)”.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatorët ekonomike duhet te disponojne ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi “*Impiant prodhimi Inerte, Impiant prodhimi Asfalti dhe Impiant prodhimi Betoni*” dhe ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqiten dokumente qe vertetojne pronesine e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion qe verteton pronesine ndersa ne rast se impianti i prodhimit te inerteve ose asfaltit eshte me qera ose kontrate bashkepunimi duhet te paraqitet kontrata e qerases ose bashkepunimit.

Nga verifikimi ne QKB rezulton Operatori Ekonomik nuk disponon leje mjedisore QKL me Kod III.1.B, per “*Impiant prodhimi Inerte, Asfalti dhe Betoni*” dhe po ashtu nga verifikimi ne SPE rezulton se Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur kontraten e qerases ose bashkepunimi me ndonje prodhues Inertesh, Asfalti dhe Betoni.

Sa me siper duke qene se Operatori Ekonomik nuk disponon leje mjedisore QKL me Kod III.1.B, per “*Impiant prodhimi Inerte, Asfalti dhe Betoni*”, si dhe duke qene se nuk eshte paraqitur kontrate qiraje ose bashkepunimi me ndonje prodhues Inertesh, Asfalti dhe Betoni ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “ALMO KONSTRUKSION” Shpk, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “ALMO KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis J91915001P, skualifikohet.

III- Operatori Ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” Shpk, me Nuis K81716011V,
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO ☒

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE ka dorezuar te gjithë dokumentacionin ne perputhje me kriteret e pergjithshme dhe te vecanta te kualifikimit te percaktuar ne dokumentat standarte te tenderit.

Komisioni i vleresimit te ofertave mbeshtetur në nenin 92, pika 3, ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, ku parashikohet shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Per sa me siper oferta e dorezuar nga OE “COMPANY RIVIERA 2008” Shpk, me Nuis K81716011V, eshte kualifikuar.

Ne vijim, Komisioni i Vleresimit te Ofertave pas **kualifikimit te 9 (nente) ofertave te vlefshme** bazuar ne ligjin nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020“Për prokurimin publik”, ne nenin 27, ku percaktohet se: “Në nenin 93 pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: **“5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”**, si dhe nenin 82/4, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme,

.....verifikoi 9 ofertat e kualifikuara te vlefshme nëse janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit ku rezultoi se vlera mesatare e 9

ofertave te paraqitura eshte 229,068,845.10 ndersa vlere e **85% e mesatares së ofertave të vlefshme** eshte $229,068,845.10 \times 85\% = 194,708,518.33$ dhe cdo vlere e ofertuar me ulet se vlere prej **194,708,518.33 konsiderohet anomalisht e ulet dhe duhet refuzuar pa kerkuar shpjegime** sipas ligjit nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020“Për prokurimin publik”.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave krahasoi vlerat e 9 ofertave te vlefshme me vleren e 85 % te mesatares se tyre ku rezultoi se nga krahasimi i ketyre ofertave jane anomalisht te uleta vetem ofertat e meposhteme:

- 1- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “EUROKOS HOLDING SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI” Dege e shoqërisë së huaj, me Nuis K91727010A & “A.L-ASFALT” Shpk, me Nuis K81511508A dhe me oferte ekonomike 169,845,048.45 (njqind e gjashtedhjetë e nente milion e teteqind e dyzet e pese mije e dyzet e tete pike dyzet e pese) Lek pa Tvsh,
- 2- Operatori Ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” Shpk, me Nuis K81716011V dhe me oferte ekonomike 194,286,239 (njqind e nentedhjetë e kater milion e dyqind e tetedhjetë e gjashte mije e dyqind e tridhjetë e nente) Lek pa TVsh,

...te cilat jane nen vleren e **85% e mesatares se ofertave** prej **194,708,518.33 dhe rrjedhimisht jane oferta anomalisht te ulet dhe duhen refuzuar pa kerkuar shpjegime** bazuar kjo ne nenin 27, te ligjin nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020“Për prokurimin publik”, si dhe nenin 82/4, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020

“Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e **OE “COMPANY RIVIERA 2008” Shpk**, për mos përmbushje të kriterëve ligjorë duke paraqitur oferte anomalisht të ulët.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” Shpk, me Nuis K81716011V, skualifikohet.

IV- Operatori Ekonomik “CURRI” Shpk, me Nuis J67902718S,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.7 të DST-se, ku parashikohet se: “*Operatoret Ekonomike duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:*”

Nr.	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 20 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 10 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	3
3	Kamion me Vinc	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
4	Kamionçine min 3.5 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
5	Eskavator me zinxhir	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
6	Fadrome	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
7	Minieskavator	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
8	Asfaltoshtruese	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
9	Grejder	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
10	Rrul Vibrues	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
11	Betoniëre kantieri	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
12	Rimorkiator	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1

13	Makineri vijezi	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
14	Aparat topogjeodezik me GPS	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronesine e mjetit: - certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe te jetë e dukshme targa e mjetit.
- Ndersa per mjete te marra me qera/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase/ bashkëpunimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qeras/ Kontrate Bashkepunimi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimitit”.

KVO veren se bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla dhe per te permbushur kete kriter operatoret ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e mjeteve qe disponon sipas percaktimeve te pikes 2.3.7 te DST-se.*

Nga verifikimi ne SPE, rezulton se ky OE ka deklaruar ne formularin e Vetedeklarimit disponimin e 2 (dy) mjeteve “**Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 10 ton**”, nga 3 (tre), te kerkuar ne DST.

Po ashtu, verehet se operatori ekonomik ne lidhje me dipsonimin e **2 (dy) mjeteve me kapacitet mbajtes mbi 3.5 ton** ka deklaruar ka deklaruar ne formularin e Vetedeklarimit se disponon mjete me kapacitet mbajtes me pak se 3.5 ton.

Sa me siper, konstatohet se operatori ekonomik nuk ka vetedeklaruar disponimin e mjetit te trete “**Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 10 ton**” *si dhe ka deklaruar se disponon mjete me kapacitet mbajtes me pak se 3.5 ton, duke mospermbushur kete kriter.*

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.9, te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet te disponoje ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi impiantet si me poshte vijon:*

a. 1 (nje) Impiant prodhimi Inerte

b. 1 (nje) Impiant prodhimi Asfalti

c. 1 (nje) Impiant prodhimi Betoni

Për impiantin e prodhimit te inerteve, asfaltit/betoni, ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqiten dokumente qe vertetojne pronesine e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion qe verteton pronesine. Ne rast se impianti i prodhimit te inerteve/asfaltit/betoni, eshte me qera ose kontrate bashkepunimi duhet te paraqitet kontrata e qerese/bashkëpunimit. (KVO do te verifikoje nepermjet QKB nese impianti i prodhimit te inerteve/asfaltit/betoni eshte i pajisur me license 3.1.B, ne rast te kundert OE do te skualifikohet)”.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatorët ekonomike duhet te disponojne ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi **“Impiant prodhimi Inerte, Impiant prodhimi Asfalti dhe Impiant prodhimi Betoni”** dhe ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqiten dokumente qe vertetojne pronesine e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion qe verteton pronesine ndersa ne rast se impianti i prodhimit te inerteve ose asfaltit eshte me qera ose kontrate bashkepunimi duhet te paraqitet kontrata e qerese ose bashkëpunimit.

Nga verifikimi ne QKB rezulton se Operatori Ekonomik nuk disponon leje mjedisore QKL me Kod III.1.B, per **“Impiant prodhimi Inerte, Asfalti dhe Betoni”** dhe po ashtu nga verifikimi ne SPE rezulton se Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnje kontrate qiraje ose bashkëpunimi me ndonje prodhues Inertesh, Asfalti dhe Betoni.

Sa me siper duke qene se Operatori Ekonomik nuk disponon leje mjedisore QKL me Kod III.1.B, per **“Impiant prodhimi Inerte, Asfalti dhe Betoni”**, si dhe duke qene se nuk eshte paraqitur kontrate qiraje ose bashkëpunimi me ndonje prodhues Inertesh, Asfalti dhe Betoni ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të

përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “CURRI” Shpk, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “CURRI” Shpk, me Nuis J67902718S, skualifikohet.

V- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” Shpk, me Nuis K82230002K & “BAJRAMI N.” Shpk, me Nuis K02727202O,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomik rezulton se:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.5 të DST-se, ku parashikohet se: Krahës stafit teknik Operatorët Ekonomikë duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si më poshtë:

- | | | |
|---|----------|---|
| - Ing. Ndertimi | 1 (nje) | Diplome Universitare |
| - Teknik ndertimi | 2 (dy) | Diplome shkolles mesme |
| - Hekurkthyes | 2 (dy) | Çertifikate/ Deshmite profesionale |
| - Karpentier | 2 (dy) | Çertifikate/ Deshmite profesionale |
| - Punonjes për punime në Rrugë dhe Asfaltim | 5 (pese) | Çertifikate/ Deshmite profesionale |
| - Shofer | 5 (pese) | Leje Drejtimi |
| - Manovrator | 5 (pese) | Certifikate e Aftësisë Profesionale (CAP) |

Operatori ekonomik duhet të paraqes për stafin e mesiperm: Kontratat individuale të punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmite profesionale/ Certifikate e Aftësisë Profesionale (CAP)/ Leje Drejtimi sipas shënimeve për çdo kategori të mesipërme si dhe stafi i mesiperm të figurojë në listepagesat e shoqërisë për periudhën Tetor 2024 - Dhjetor 2024.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) që nuk është leshuar sipas legjisllacionit përkatës të arsimimit profesional do të konsiderohen jo të sakta dhe behen shkak për veprime të metejshme sipas parashikimeve përkatëse të ligjit të prokurimit publik.

